



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCËVE - MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE - MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE
ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS - PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA - TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 2004/48 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat si i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2004/48 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës

Nxjerr:

Vendim Shpjegues Publik

për

Trajtimin për çështje tatimore i Pensioneve me shumë të tërësishme

1. Paragrafi 1.9 i nenit 6 të Ligjit Nr. 03/L-115 për Tatimin në të Ardhura Personale, parasheh që Pensionet e paguara nga Qeveria, një të punësuarit të mëhershëm, apo në përputhje me Ligjin mbi Fondet Pensionale të Kosovës do të përfshihen në të ardhurat bruto.
2. Neni 5 i Ligjit Nr. 03/L-115 për Tatimin në të Ardhura Personale, parasheh përqindje të përshkallëzuara të cilat rezultojnë me shumën e tatimit që do të ngarkohet mbi nivelet e ndryshme të të ardhurave të tatueshme.
3. Ligji mbi Pensionet kërkon që çdo individ, fondi pensional i të cilit është më pak se 2,000€ në kohën e pensionimit, duhet të tërheqë shumën e pensionit si një shumë të tërësishme dhe nuk ka mundësi të marrë shumën e pensionit të shpërndarë gjatë jetës së mbetur të atij individi.
4. Kërkesa për të tërhequr fondin pensional që arrin shumën më pak se 2,000 € rezulton tek pensioneri me të ardhura të ulëta të cilat taten e që normalisht nuk do të taten nëse janë paguar gjatë jetës së tyre të pritur.
5. Jeta mesatare e pritur e meshkujve në Kosovë është 67 vjet dhe e femra është 71 vjet.

Duke pas parasysh sqarimet më sipër, është nxjerrë vendimi shpjegues si më poshtë , i cili aplikohet vetëm për pagesat pensionale me shumë të tërësishme prej 2,000€ apo më pak. Për aplikim praktik, shih shembullin në aneksin e këtij vendimi shpjegues.

6. Një pagesë pensioni me shumë të tërësishme prej 2,000 € a më pak do të trajtohet sikur të ishte paguar gjatë një periudhe prej dy viteve dhe të taten sikur të ishte marrë 50% në vitin e parë dhe 50% në vitin e dytë (kjo do ta përfronte me ndikimin tatimor të pranimit të pensionit gjatë jetës së mbetur të pensionerit).

7. Pagesa pensionale me shumë të tërësishme prej 2,000 € a më pak do të tatóhet me përqindjet e përshkallëzuara të aplikueshme në të ardhurat vjetore, pa marrë parasysh se kur janë marrë gjatë vitit.
8. Nëse një pranues i një pagese pensioni me shumë të tërësishme prej 2,000€ a më pak, ka të ardhura tjera, shuma e aplikueshme pensionale do të përfshihet në deklaratën vjetore të Tatimit në të Ardhurat Personale të dorëzuar për të raportuar të ardhurat tjera.
9. Një pagesë pensioni me shumë të tërësishme prej 500€ a më pak do të trajtohet si të ishte pranuar në vitin e pranimit dhe do të tatóhej në përqindjet e përshkallëzuara të aplikueshme për të ardhurat vjetore.
10. Për qëllime të këtij vendimi shpjegues, nuk do të kërkohet mbajtje e tatimit në burim , nëse shuma që do të mbahej në burim për një pagesë pensioni, është më pak se 2€.
11. Një pranues i një pagese pensioni me shumë të tërësishme prej 2,000€ a më pak, i cili nuk ka të ardhura që i nënshtrohen tatimit përveç pagesës së pensionit me shumë të tërësishme për vitin, nuk kërkohet të dorëzojë deklaratë vjetore apo pagesë tatimore, nëse shuma totale që do të ishte obligim në deklaratën vjetore nuk tejkallon 2€.

Drejtor i përgjithshëm i ATK-së
Behxhet Haliti



Data
15 / 07 / 2009

Aneks

Mënyra e aplikimit të Vendimit Shpjegues

1. Tatimpaguesi A, i moshës 65, ka marrë pagesën pensionale me shumë të tërësishme më 10 Mars 2009. Pagesa e shumës së tërësishme ka qenë 2,000€, dhe është e vetmja e ardhur e pranuar nga tatimpaguesi në vitin 2009. Tatimpaguesi do të konsiderohet të ketë marrë 1,000€ të pagesës së shumës së tërësishme në vitin 2009 dhe 1,000€ të pagesës së shumës së tërësishme në vitin 2010.

Paguesi i pensionit do të konsiderojë se 50% e pagesës pensionale me shumë të tërësishme është e tatueshme në vitin 2009 me përqindje të përshkallëzuar të aplikueshme në të ardhurat vjetore.

Llogaritja e paguesit:

| | |
|--|-------|
| Pagesa për Tatimpaguesin A: | 1,000 |
| Të ardhura vjetore të pa tatueshme: | -960 |
| Shuma e të ardhurave që i nënshtrohen mbajtjes në burim: | 40 |
| Shkalla e mbajtjes në burim 4% (40 X 4% = €1.60): | 1.60 |

Për shkak se shuma për t'u mbajtur në burim është më e vogël se 2€, paguesi i pensionit me pagesë të tërësishme nuk kërkohet të mbajë tatimin në burim për pensionin me shumë të tërësishme. Nga paguesi i pensionit nuk do të kërkohet që të mbaj tatimin në burim as për shumën e pensionit që gjykohet të jetë paguar për vitin 2010, për faktin se ajo mbajtje në burim gjithashtu do të ishte më pak se 2€.

Llogaritja e Tatimpaguesit A (pranuesit të pensionit) (2009):

| | |
|--|-------|
| Pagesa për Tatimpaguesin A: | 1,000 |
| Të ardhura vjetore të pa tatueshme: | -960 |
| Shuma e të ardhurave që i nënshtrohen tatimit: | 40 |
| Tatimi me 4% (40 X 4% = €1.60): | 1.60 |

Për shkak se Tatimpaguesi A nuk ka të ardhura tjera që i nënshtrohen tatimit dhe shuma totale e obligimit tatimor në pagesën pensionale me shumë të tërësishme është më pak se 2€, tatimpaguesi A nuk ka nevojë të dorëzojë deklaratë vjetore dhe nuk ka nevojë të paguajë ndonjë shumë të tatimit.

2. Në vitin 2010, Tatimpaguesi A ka pasur të ardhura të tatueshme prej 2,000 € nga një biznes që ai e ka filluar në vitin 2010. Shumën e pensionit prej 1,000 € nga pagesa pensionale me shumë të tërësishme që ai e ka marrë në vitin 2009 do të bashkohet me të ardhurat e tij të biznesit dhe do të përfshijë në Deklaratën e tij të Tatimit në të Ardhurat Personale për vitin 2010.

Llogaritja e Tatimpaguesit A (2010):

| | |
|--|--------------|
| Të ardhurat neto nga biznesi: | 2,000 |
| Pagesa për Tatimpaguesin A: | <u>1,000</u> |
| Të ardhurat e përgjithshme | 3,000 |
| Të ardhura vjetore të patatueshme: | -960 |
| Shuma e të ardhurave që i nënshtrohen tatimit: | 2,040 |
| Tatimi në të ardhura 4% (2040 X 4%): | 81.60 |